

PROJEKT- REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË GRUPIT TË DEPUTETËVE “MIQTË E FËMIJËVE” PËR VITIN 2018 DHE PËR PLANIN E VEPRIMIT PËR VITIN 2019

Kuvendi i Shqipërisë:

1. Duke vlerësuar angazhimin e Grupit të Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” (GDMF) në advokimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, në marrjen e nismave ligjore dhe hartimin e politikave efektive për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe në forcimin e kontrollit parlamentar për realizimin e këtyre të drejtave;
2. Duke mbështetur GDMF për angazhimin në mbrojtjen dhe fuqizimin e fëmijëve e të rinjve në Shqipëri; qasjen pro-aktive për ta vendosur interesin më të lartë të fëmijëve dhe të rinjve në qendër të vemendjes gjatë diskutimit dhe miratimit të ligjeve, politikave dhe programeve kombëtare në Shqipëri dhe për ndërmarrjen e nismave në nivel vendor e kombëtar, rajonal e ndërkombëtar për përparimin e të drejtave të fëmijëve, sikurse është pasqyruar edhe në Raportin Vjetor të GDMF-së për vitin 2018;
3. Duke konsideruar bashkëpunimin me institucionet shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë për fëmijët, si edhe dialogun me vetë fëmijët, si një element thelbësor në kapërcimin e sfidave të përbashkëta për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe realizimin e gjithë masave të nevojshme për sigurimin e një klime mbështetëse për fëmijët në Kuvendin e Shqipërisë;

Pas shqyrtimit të raportit vjetor të grupit të deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”, Kuvendi i Shqipërisë konstaton se gjatë vitit 2018:

4. GDMF ka zhvilluar në vazhdimësi aktivitete, takime dhe sesione informuese me fëmijë dhe të rinj nga i gjithë vendi, me qëllim krijimin e një klime mbështetëse për fëmijët në Kuvendin e Shqipërisë dhe evidentimin e problematikave konkrete që lidhen me të drejtat e fëmijëve. Kuvendi i Shqipërisë ka mirëpritur 12 700 fëmijë;
5. Është rritur niveli i kontrollit parlamentar të ushtruar ndaj institucioneve kushtetuese ose të krijuara me ligj dhe agjencive publike që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet realizimit të seancave dëgjimore dhe takimeve të komiteteve të GDMF-së me partnerët dhe bashkëpunëtorët.
6. Krahas angazhimit në veprimtarinë e zhvilluar në kuadër të GDMF-së, deputetët, anëtarë të tij, kanë marrë pjesë aktive në mbledhjet që komisionet e përhershme parlamentare kanë zhvilluar për çështjet e fëmijëve. Gjatë vitit 2018, komisionet e përhershme parlamentare kanë zhvilluar 18 seanca, në të cilat janë shqyrtuar, diskutuar/miratuar projektligje të cilat prekin çështje që lidhen me të drejtat e fëmijëve si dhe janë dëgjuar raportime të ministrave, të përfaqësuesve të ministrive, institucioneve në varësi dhe institucioneve të krijuara me ligj.

7. Deputetë të GDMF-së ndërmorën nismën ligjore për adresimin e problemeve që kishin të bënin me regjistrimin e fëmijëve në gjendjen civile. Propozimi i deputetëve u hartua në bashkëpunim me UNICEF, UNHCR, ekspertë të pavaruar dhe në konsultim me shoqërinë civile. Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 69/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”.

8. GDMF bashkëpunon me institucione të administratës publike, institucionet e pavarura të drejtave të njeriut, partnerë ndërkombëtarë, organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të botës akademike, biznesin, median, grupet e fëmijëve dhe të rinjve dhe çdo të interesuar në fushën e të drejtave të fëmijëve, Falë bashkëpunimit me këta aktorë, veçanërisht më fëmijët, është rritur ndjeshmëria publike në evidentimin dhe adresimin e problematikave konkrete që prekin gëzimin e të drejtave të fëmijëve.

9. GDMF organizoi dëgjesa, me qëllim prezantimin e raporteve të hartuara prej fëmijëve dhe të rinjve nga bashki të ndryshme mbi nivelin e respektimit dhe gëzimit të të drejtave të tyre, sidomos nga institucionet shtetërore dhe për rolin që luan pjesëmarrja e fëmijëve në vendimmarrjen publike.

10. Komitetet e GDMF u konstituan duke bërë një rishpërndarje të deputetëve në to, si nevojë e reflektimit të shtimit të numrit të deputetëve -anëtarë të GDMF.

11. GDMF rishikoi dhe miratoi rregulloren e vet të brendshme, si dhe Planin Strategjik të Veprimtimit (2018-2021).

12. GDMF vijoi veprimtarinë për avancimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve.

Kuvendi i Shqipërisë i kërkon GDMF-së për vitin 2019, të përqendrohet në këto drejtime:

1. Angazhimin në bashkëpunim me komisionet e përhershme parlamentare në shqyrtimin e nismave që mundësojnë përmirësimin e mirëqënies dhe shëndetin e çdo fëmije, mes të cilave dhe projektligjin “Për ndihmën ekonomike”, dhe përmirësimet ligjore përsa i takon jodizimit të kripës dhe ndikimit në shëndetin e fëmijëve, sipas kalendarit të punimeve të Kuvendit të Shqipërisë;

2. Analizimin e kalendarit të nismave ligjore të qeverisë me fokus ligjet/ nismat ligjore me ndikim në të drejtat e fëmijëve brenda muajit qershor 2019;

3. Mbikëqyrjen mes formave të kontrollit parlamentar të zbatimit të ndryshimeve të miratuara në ligjin “Për gjendjen civile” në vijimësi;

4. Diskutimin e raportit zyrtar të Republikës së Shqipërisë për të Drejtat e Fëmijës, përpara dorëzimit pranë Komitetit të Konventës së Kombeve të Bashkuara si dhe vlerësimin për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Konventë dhe nga Objektivat e Zhvillimit të

Qëndrueshëm lidhur me fëmijët dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Komitetit për të Drejtat e fëmijëve në mënyrë sistematike, brenda muajit prill 2019;

5. Ndjekjen, në bashkëpunim me komisionet e përhershme parlamentare të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale për çështje të të drejtave të fëmijëve, si dhe realizimin e të paktën një dëgjese publike me këto institucione për fuqizimin e rolit të tyre dhe përmirësimin e respektimit e garantimit të të drejtave të fëmijëve;

6. Realizimin e dëgjesave me Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për de-institucionalizimin e Fëmijëve, sigurimin e familjeve alternative dhe përmirësimin e procedurës së birësimit, duke përfshirë opinionin e fëmijëve, si dhe për zbatimin dhe buxhetimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve;

7. Monitorimin në vazhdimësi të ecurisë së reformës së drejtësisë për të mitur;

8. Tërheqjen e mendimit të fëmijëve dhe adoleshentëve përmes forumeve dhe grupimeve të tyre rajonale.

Kuvendi i Shqipërisë u kërkon institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve për vitin 2019, të përqendrohen në këto drejtime:

9. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) të vazhdojë punën mbi hartëzimin e shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve të kujdesit social për fëmijë në nivel kombëtar dhe buxhetimin e tyre progresiv. MSHMS të informojë GDMF jo më vonë se muaji shtator 2019 për ecurinë e punës;

10. MSHMS të përfundojë reformën e de-institucionalizimit të fëmijëve si dhe të marrë masa për gjetjen dhe mbështetjen e familjeve të origjinës ose alternative, si dhe të lehtësojë procedurat e birësimit duke marrë parasysh opinionin dhe interesin më të lartë të fëmijëve. MSHMS të informojë GDMF jo më vonë se muaji shtator 2019 për ecurinë e zbatimit të kësaj reforme;

11. Në zbatim të Konventës për Personat me Aftësi të Kufizuar (PAK), MSHMS të sigurojë mos diskriminimin dhe sigurimin e aksesit në shërbime sidomos aksesin fizik në institucione publike dhe private, aksesin në transportin publik, sigurimin e informacionit online të aksesueshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara. MSHMS të informojë GDMF në muajin Shtator 2019 dhe në muajin Dhjetor 2019 lidhur me ecurinë e aksesueshmërisë fizike në ndërtesat e institucioneve publike dhe jo publike;

12. Për të mundësuar arsimin gjithëpërfshirës, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve (MARS) të rrisë numrin e mësuesve mbështetës dhe të vazhdojë trajnimin e mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në të gjithë vendin për vitin arsimor 2019-2020. MARS të

informojë GDMF jo më vonë se se data 15 shtator 2019 lidhur me përmbushjen e këtij rekomandimi;

13. Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF) të udhëheqë dhe të realizojë analiza të plota sektoriale, me qëllim parashikimet e nevojshme buxhetore për të mbështetur politikat dhe shërbimet për realizimin e të drejtave të fëmijëve. Projektbuxheti për vitin 2020 të përmbajë tregues konkretë të buxhetit për politika dhe shërbime për fëmijët. Projektbuxheti për shërbimet për fëmijët të konsultohet me organizatat e shoqërisë civile para dërgimit për miratim në Kuvend. Projektbuxheti i vitit 2020 të shoqërohet me një raport të rekomandimeve të adresuara dhe atyre të paadresuara;

14. MEF të ndjekë me përparësi trajnimin profesional dhe ofrimin e mundësive të përshtatshme për punësim të adoleshentëve dhe të rinjve. MEF të informojë GDMF jo më vonë se muaji Nëntor 2019 për ecurinë e përmbushjes së këtij rekomandimi;

15. Ministria e Drejtësisë të sigurojë dhe mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit në fushën e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe Ndihmës Ligjore të Garantuar nga Shtetit, të trajnojnë personelin në institucionet e varësisë, dhe të krijojë bazën e të dhënave për të miturit në konflikt/kontakt me ligjin. Jo më vonë se muaji Shtator 2019, MD të informojë GDMF për ecurinë e përmbushjes së këtij angazhimi;

16. Organet e sistemit të drejtësisë përgjegjëse për hartimin dhe miratimin e hartës së re gjyqësore të marrin masa të menjëhershme për përcaktimin e hartës së re gjyqësore, me synim ngritjen e seksioneve ose specializimin e magistratëve për të mitur në çdo juridiksion. Jo më vonë se muaji Shtator 2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë të informojnë GDMF për përmbushjen e këtij angazhimi;

17. Organet e reja të vetëqverisjes vendore të hartëzojnë shërbimet për fëmijë dhe të rinj, të planifikojnë buxhetimin e shërbimeve të përshtatshme për ta, si dhe të marrin masa për përmbushjen e të drejtave dhe nevojave të fëmijëve në territorin e tyre, veçanërisht atyre me nevoja të veçanta. GDMF do të analizojë përmbushjen e këtij detyrimi nga gjashtëdhjetë e një njësitë të vetëqverisjes vendore në muajin Nëntor 2019.

Miratuar në datën _____

KRYETARI
Gramoz Ruçi



KUVENDI I SHQIPËRISË
Grupi i deputetëve “Miqhtë e Fëmijëve”

RAPORT PËR VEPRIMTARINË E GRUPIT TË DEPUTETËVE “MIQTË E FËMIJËVE”,
PËR VITIN 2018

I. Hyrje

Grupi i Deputetëve “Miqhtë e fëmijëve”(GDMF) është një grupim i deputetëve që funksionon si një grup ad-hoc në Kuvendin e Shqipërisë. Pjesëmarrja në të është e hapur për çdo deputet të Kuvendit.

Pas ftesave të herë pas hershme drejtuar deputetëve të Kuvendit, anëtarësia e GDMF është zgjeruar me anëtarë të rinj. Gjatë vitit 2018 grupi përbëhet nga 32 parlamentarë: 28 anëtarë si edhe kryetari e 3 zëvendëskryetarët. Përbërja e grupit të deputetëve “Miqhtë e fëmijëve” pasqyrohet në shtojcën nr.1, bashkëlidhur këtij raporti.

Qëllimi i GDMF është ndjekja sistematike e zbatimit të Rezolutës “Për Mbrojtjen dhe Respektimin e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në Nëntor 2013.

Synimi i GDMF është angazhimi i deputetëve që kanë treguar ndjeshmëri dhe advokojnë për të drejtat e fëmijëve me qëllim që të krijohet një klimë mbështetëse për çështjen e fëmijëve në Kuvendin e Shqipërisë, marrjen e nismave ligjore, hartimin e politikave efektive për parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve, si dhe për të garantuar që institucionet shtetërore që punojnë për fëmijët do të kenë mbështetje në punën e tyre nga Kuvendi dhe do të japin llogari përpara tij për arritjet dhe sfidat.

Roli i GDMF është ndërmarrja e nismave legislative të përbashkëta me shoqërinë civile/deputetëve të veçantë, për mbrojtjen e fëmijëve; ndërgjegjësimi i publikut mbi situatën e të drejtave të fëmijëve dhe rëndësinë e respektimit të tyre; organizimi i seancave dëgjimore, pyetjeve dhe interpelancave me përfaqësues të Qeverisë dhe OJF-ve për të mbledhur informacion mbi situatën e fëmijëve; promovimi i instrumenteve të reja ligjore ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve; monitorimi i progresit të Shqipërisë në lidhje me zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës dhe në mënyrë të veçantë të *Aquis* të Bashkimit Evropian; sjellja në vëmendjen e Kuvendit të Shqipërisë dhe deputetëve të saj të raporteve dhe të dhënave që flasin për ndikimin dhe pasojat e dhunës, shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit kundër fëmijëve; alokimi i burimeve financiare të mjaftueshme për promovimin dhe mbështetjen e shërbimeve për fëmijët, në nivel vendor dhe kombëtar.

Qëllimet strategjike të GDMF përfshijnë mbrojtje dhe fuqizim të fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri dhe angazhim pro-aktiv për ta vendosur interesin më të lartë të fëmijëve dhe të rinjve, në qendër të Ligjeve, politikave dhe programeve kombëtare në Shqipëri dhe ndërmarrjen e nismave në nivel vendor e kombëtar, rajonal e ndërkombëtar për avancimin e të drejtave të fëmijëve.

Struktura e GDMF-së

GDMF përbëhet nga:

Kryetari

Kryetari i Kuvendit është edhe Kryetari i GDMF. Kryetari është përgjegjës për drejtimin e mbledhjeve/takimeve të GDMF. Ai raporton një herë në vit në seancë plenare të Kuvendit për veprimtarinë e GDMF.

Zëvendëskryetarët

GDMF ka 3 Zëvendëskryetarë të cilët janë përgjegjës për bashkëorganizimin dhe drejtimin e mbledhjeve/takimeve, asistencën për kryetarin, përcaktimin e agjendës së mbledhjeve të GDMF dhe propozimin e nismave dhe aktiviteteve kryesore të grupit. Drejtimi i Koordinimit rregullohet me rotacion mes tre zëvendëskryetarëve me konsensus mes tyre në baza 4/6 mujore.

Gjatë vitit 2018, zëvendëskryetarë të grupit të deputetëve “Miq të fëmijëve” janë: znj. Eglantina Gjermeni, kryetare e Nënkomisionit për barazi gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj grave, z. Petrit Vasili, kryetar i Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe znj. Vasilika Hysi, kryetare e Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut.

Komitetet

GDMF ka në përbërje disa komitete të përbërë nga deputetë, për të ndjekur çështje me interes për ta.

Komitetet e GDMF janë: Komiteti për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna; Komiteti për të Miturit në Konflikt me Ligjin; Komiteti për Fëmijët në Institucione Publike; Komiteti për Shëndetin dhe Mirëqenien e Fëmijëve; Komiteti për Marrëdhëniet me OSHC-të; Komiteti për Buxhetin e Fëmijëve. Përbërja e komiteteve paraqitet në shtojcën n.2, bashkëlidhur këtij raporti.

Komitetet propozojnë dhe ndërmarrin nisma e iniciativa të lidhura me çështjet që mbulojnë në zbatim të objektivave strategjike.

Për qëllime të organizimit dhe funksionimit të tij, në mbledhjet e zhvilluara gjatë vitit 2018 GDMF ka miratuar Rregulloren e brendshme të funksionimit, Planin Strategjik dhe të Veprimit 2018-2021 dhe kalendarin e veprimtarive. Përmbajtja e tyre është bashkëlidhur këtij raporti.

Komunikimi i GDMF

GDMF mban komunikim me publikun, institucionet, medien, etj., përmes një rubrike të posaçme për GDMF në faqen e internetit të Kuvendit; fletëpalosjeve; udhëzuesit “Çfarë parlamentarët mund të bëjnë për të mbrojtur fëmijët nga dhuna”; prezantimeve medietike, etj.

II. VEPRIMTARIA PËR VITIN 2018

II.1. Gjatë vitit 2018 Grupi i Deputetëve "Miq të fëmijëve" ka organizuar mbledhje, takime, aktivitete me fëmijët, shoqërinë civile, grupet e interesit, seanca dëgjimore me drejtues dhe përfaqësues të institucioneve kushtetuese, apo të krijuara me ligj, ministra etj., ndër të cilat:

➤ ***Mbledhje lidhur mënyrën e organizimit dhe funksionimit të GDMF-së***

Janë zhvilluar 3 mbledhje me rend dite çështje të organizimit dhe funksionimit të grupit, në të cilat është bërë konstituimi i grupit, miratimi i komiteteve dhe anëtarësisë së tyre dhe janë miratuar edhe dokumentet e punës së grupit, rregullorja e brendshme, plani strategjik dhe i veprimit dhe kalendari i aktiviteteve.

➤ ***Takime me fëmijë dhe sesione informimi të tyre:***

GDMF:

- Ka mirëpritur në 4 takime dhe sesione informuese fëmijë e të rinj nga gjithë vendi, duke zhvilluar: orë informuese mbi mënyrën e përdorimit, nga fëmijët, të formularëve elektronikë në faqen e internetit parlament.al; sesione informuese me qëllim njohjen e programit parlamentar nga fëmijët; informimin lidhur me procedurat e pjesëmarrjes së publikut/fëmijëve në veprimtaritë parlamentare dhe mënyrat e aksesit ndaj informacionit parlamentar.
- Ka mirëpritur 400 fëmijë jetimë, në dy aktivitete të zhvilluara në datat 19 dhe 20 maj, në sallën e seancave plenare, në kuadër të ditës kombëtare të jetimëve. Në këto takime ishin të ftuar të gjithë deputetët e Kuvendit, ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale, ministrja e Arsimit, ministri i Shtetit për Disaporën, Avokatja e Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përfaqësues nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Shërbimi Social Shtetëror. Fëmijët jetimë informuan deputetët për problematikat që rrjedhin nga zbatimi i ligjit për statusin e jetimit. Kryetari i Kuvendit kërkoi nga ministrat dhe drejtuesit e institucioneve të pranishëm në takim, marrjen e masave konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara nga fëmijët jetim, Shoqata Kombëtare e Jetimëve të Shqipërisë dhe Instituti Kombëtar i Integritetit të Fëmijëve Shqiptarë.
- Ka zhvilluar aktivitete me fëmijët, në kuadër të bashkëpunimit me drejtoritë arsimore, ditë të dyerve të hapura, ku fëmijët kanë vizituar mjediset e kuvendit dhe janë njohur me kuvendin si institucion kushtetues, rolin dhe funksionet e tij.
- Ka zhvilluar aktivitete në kuadër të programeve mësimore individuale të shkollave dhe universiteteve.

Numri i fëmijëve/të rinjve të mirëpritur në Kuvend gjatë vitit 2018 është 12 700.

➤ ***Paraqitja e raporteve të hartuara nga vetë fëmijët.***

- Në datën 1 qershor 2018 është organizuar Dita e fëmijëve në Kuvendin e Shqipërisë, ku një grup fëmijësh, të rinjsh, nga disa rrethe të Shqipërisë, që përfaqësojnë grupin e fëmijëve “Zëri 16+” kanë prezantuar raportin e hartuar nga vete ata mbi gjendjen e respektimit të të drejtave të fëmijëve në institucionet arsimore. Fëmijët bënë një prezantim të situatës, duke evidentuar gjetjet kryesore në qytete të ndryshme, si dhe adresuan rekomandime konkrete, sipas fushave, me qëllim përmirësimin e gjendjes së respektimit të të drejtave të fëmijëve.

Në këtë takim morën pjesë edhe ministrja e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, ministrja e Drejtësisë, Avokatja e Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përfaqësues nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Shërbimi Social Shtetëror, të cilët u angazhuan në marrjen e masave konkrete.

- Në një takim me një grup fëmijësh nga 5 qytete të Shqipërisë, anëtarët e GDMF, por edhe deputetë të tjerë të Kuvendit, të ftuar për të marrë pjesë, u njohën me raportin e hartuar nga fëmijët mbi rolin që luan Parlamenti Rinor në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve. Në këtë takim u diskutua edhe mundësia që GDMF ka për të krijuar një dialog dhe komunikim të qëndrueshëm ndërmjet deputetëve dhe fëmijëve.

➤ ***Seanca dëgjimore***

- ***Seancë dëgjimore për trajtimin e problematikave të pashtetësisë në Shqipëri***

GDMF ka zhvilluar 1 seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit të përgatitur nga TLAS (Klinika ligjore falas në Tiranë), me mbështetjen e agjencive të Kombeve të Bashkuara UNICEF dhe UNHCR, në kuadër të Koalicionit për të Drejtën e Çdo Fëmije për Shtetësi, për situatën e pashtetësisë në Shqipëri.

Raporti analizonte problemin e pashtetësisë në vend, grupet e shoqërisë që prek, mungesat në legjislacion dhe hapat e ndërmarrë deri tani nga institucionet përkatëse për adresimin e këtyre problematikave, me qëllim realizimin e një zgjidhjeje të qëndrueshme të kësaj çështje.

- ***Seancë dëgjimore për zbatimin e agjendës së Kuvendit për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe kontrollit parlamentar për zbatimin e të drejtave të fëmijëve***

GDMF, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut së bashku dhe me Nënkomisionin për të Drejtat e Njeriut, në kuadër të ushtrimit të funksionit të kontrollit parlamentar, zhvilluan një seancë dëgjimore me Ministren e Drejtësisë lidhur me masat e marra në zbatim të Ligjit nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” si dhe Ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Ministrja e Drejtësisë informoi për masat ligjore dhe organizative të ndërmarra për zbatimin e dy ligjeve.

Në takim morën pjesë edhe përfaqësues të delegacionit të BE-së për Shqipërinë; përfaqësuesi i UNICEF-it në Shqipëri, përfaqësues nga Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, EURALIUS, ambasada suedeze, franceze, hollandeze dhe italiane dhe organizatat ndërkombëtare “Save The Children” dhe “Terres des hommes”.

Në takim u kërkuar adresimi sa më parë i disa çështjeve që lidhen me; përdorimin e gjerë të masave të dënimit alternativ, dhënien e drejtësisë për të mitur sa më pranë vendbanimit të të miturve; sigurimin e të dhënave të koordinuara nga institucioni; rritjen e kapaciteteve njerëzore të personelit që shërben në sistemin e drejtësisë, të burgjeve apo të riedukimit.

Me qëllim adresimin e këtyre çështjeve, deputetët kërkuar nga ministria e drejtësisë që puna e këtij institucioni, në 1 deri në 2 vitet e ardhshme, të përqendrohet në harmonizimin e legjislacionin shqiptar të normave dhe garancive të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur; mbështetjen e mëtejshme të zbatimit të ligjit; legjislacionin e qartë; harmonizim efikas ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe trajtimin e personelit përgjegjës.

➤ ***Takime të komiteve të GDMF-së***

Janë zhvilluar 3 mbledhje për konstituimin e Komitetit për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna; Komitetit për të Miturit në Konflikt me Ligjin; Komitetit për Fëmijët në Institucione Publike; Komitetit për Shëndetin dhe Mirëqenien e Fëmijëve; Komitetit për Marrëdhëniet me OSHC-të; Komitetit për Buxhetin e Fëmijëve, duke bërë edhe një rishpërndarje të deputetëve në to, për shkak të shtimit të numrit të deputetëve anëtarë të GDMF.

Në këto mbledhje është diskutuar dhe miratuar plani i punës dhe kalendari i veprimtarive të Komiteteve.

II.2. Angazhimi i anëtarëve të GDMF-së në komisionet e përhershme parlamentare dhe nënkomisione që trajtojnë çështje të të drejtave të fëmijëve

Përveç angazhimit në veprimtarinë e zhvilluar në kuadër të GDMF, deputetët, anëtarë të tij, kanë marrë pjesë aktive edhe në mbledhjet që komisionet e përhershme parlamentare kanë zhvilluar për çështjet e fëmijëve.

Gjatë vitit 2018 komisionet e përhershme parlamentare kanë zhvilluar 18 seanca, në të cilat janë shqyrtuar, diskutuar/miratuar projektligje të cilat prekin çështje që lidhen me të drejtat e fëmijëve dhe janë dëgjuar raportime të ministrave, përfaqësuesve të ministrave, institucioneve në varësi, institucioneve të krijuara me ligj, nga të cilat:

- 6 seanca për shqyrtim/miratim projektligji;
- 12 seanca e dëgjimore me ministra, drejtues/përfaqësues të ministrave, institucioneve në varësi, institucione të krijuara me ligj, përfaqësues të grupeve të interesit, të shoqërisë civile dhe ekspertë.

III. NDRYSHIMET LIGJORE TË PROPOZUARA NGA GDMF

Në vijim të seancës dëgjimore të zhvilluar nga GDMF-ja, për trajtimin e problematikave me të cilat ndeshen fëmijët pashtetësi, të cilat lidhen kryesisht me regjistrimin e tyre në zyrat e gjendjes civile, në institucionet arsimore, publike apo private, me përfitimin e shërbimeve sociale, etj., Kryetari i GDMF-së kërkoi nga deputetët anëtarë të tij, që me ndihmën e ekspertëve të përgatisin dhe t'i propozojnë Kuvendit nisma konkrete për ndryshime në legjislacion.

Për këtë qëllim, një grup deputetësh, anëtarë të GDMF-së, me mbështetjen teknike të ekspertëve të TLAS-it, hartuan dhe i propozuan Kuvendit projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”.

Bazuar në kalendarin e punës së Kuvendit, ky projektligj u shqyrtua nga Komisioni parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës.

Deputetët propozues të nismës, anëtarë të GDMF-së, së bashku me ekspertët e TLAS-it, morën pjesë në seancën dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Ligji 69/2018 u miratua në seancën plenare të datës 11 tetor 2018, duke përcaktuar tashmë procedura të qarta për përcaktimin e pashtetësisë dhe mundësimin e regjistrimit ose lëshimit të dokumenteve të udhëtimit apo qëndrimit për personat në këtë status dhe lehtësimin e barrierave ligjore dhe administrative për të mundësuar regjistrimin e fëmijëve shqiptarë të lindur jashtë vendit, ose edhe të atyre të lindur në Shqipëri, të cilët u përkasin kategorive të marginalizuara.

IV. REZULTATET E VEPRIMTARISË SË GDMF

Si rezultat i veprimtarisë së zhvilluar nga GDMF-ja gjatë vitit 2018:

- Është rritur ndërgjegjësimi dhe ndjeshmëria e deputetëve anëtarë të GDMF-së, por edhe e gjithë deputetëve të Kuvendit, duke krijuar një klimë mbështetëse për çështjen e fëmijëve në Kuvendin e Shqipërisë;
- Janë evidentuar dhe adresuar problematika konkrete që lidhen me të drejtat e fëmijëve, duke propozuar dhe miratuar ndryshime në legjislacion;
- Është rritur niveli i kontrollit parlamentar të ushtruar ndaj institucioneve kushtetuese apo të krijuara me ligj dhe agjencive publike që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve;
- Nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë civile është rritur ndjeshmëria në evidentimin dhe adresimin e problematikave konkrete që prekin të drejtat e fëmijëve;
- Janë propozuar aktivitete dhe detyra konkrete për avancimin e agjendës së fëmijëve.

V. PARTNERËT /BASHKËPUNËTORËT E GDMF

Për të realizuar qëllimin e krijimit të tij dhe për të përmbushur objektivat strategjikë GDMF ka bashkëpunuar me institucione publike, institucione të pavarura, organizata të shoqërisë civile, botën akademike, biznesin, medien, grupet e fëmijëve dhe të rinjve dhe çdo të interesuar.

Gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tij për vitin 2018, GDMF ka bashkëpunuar dhe është mbështetur nga një numër i madh partnerësh/bashkëpunëtorësh:

- Institucione shtetërore dhe/ose të krijuara me ligj:

Ministria e Drejtësisë; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve; Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit; Avokati i Popullit; Ministria e Brendshme; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Shërbimi Social Shtetëror; Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile; Ministria e Shtetit për Diasporën; Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme; Drejtoritë Rajonale Arsimore.

- Grupe interesi, organizata të shoqërisë civile, vendase dhe ndërkombëtare, ekspertë:

UNICEF, me të cilin është nënshkruar edhe një Memorandum Mirëkuptimi për bashkëpunimin për përparimin e të drejtave të fëmijëve, UNDP, OSBE, EU DELEGATION, SAVE THE CHILDREN, TERRES DES HOMMES, WORLD VISION, CARITAS, TLAS, Qendra "Për një Vizion Bashkëkohor Rom", SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri, Qendra "Fëmijët Sot", Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë, Rrjeti QZHK "Sot për të ardhmen", Shërbimi Ligjor Falas (TLAS), Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, Koalicioni për Arsimin e Fëmijëve në Shqipëri, Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare, ARSIS - Organizatë Shoqërore për Përkrahjen e të Rinjve, Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën - SHKEJ, CRCA, Alo 116, Rrjeti Kombëtar i të Rinjve në Shqipëri, Organizata EESTEC, Tirana (Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri), Organizata AYSE (Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri), Lëvizja Rinore, Puke (Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri), Together Albania (Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri), Shoqata "Të ndryshëm dhe të barabartë", Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara, QSHPLI, Fondacioni "Down Syndrome Albania", Qendra për Nisma Ligjore për qytetarët, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Ambasada e Suedisë, Grupi i Fëmijëve "Zëri 16 +...", Prindër, Mësues, Instituti Kombëtar i Integritit të Fëmijëve Shqiptarë, shoqata Kombëtare e Jetimëve Shqiptarë.

VI. OBJEKTIVAT AFATMESME 2019 - 2021

Në planin strategjik dhe të veprimit 2018-2021, GDMF ka planifikuar kryerjen e veprimtarive si:

- organizimin e sesioneve/workshop-eve me parlamentarët për të përmirësuar vlerësimin kritik të projektligjeve dhe raporteve për të drejtat e fëmijëve;
- analizimin e Kalendarit Ligjor të Qeverisë me fokus ligjet/nismat ligjore me ndikim të madh në të drejtat e fëmijëve;

- identifikimin e ligjeve/nismave me ndikim në të drejtat e fëmijëve;
- propozime për përmirësimin e kuadrit ligjor për ushqyerjen e fëmijëve, mbrojtjen efektive të Fëmijëve në Internet, zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, etj;
- analizimin e progresit të të drejtave të fëmijëve dhe identifikimin e mangësive për t'u adresuar;
- seanca dëgjimore në kuadër të kontrollit parlamentar, me institucione të ngarkuara për zbatimin e të drejtave të fëmijëve;
- vizita të anëtarëve të GDMF në institucione publike/private, bashki, shoqata që kanë në fokus të drejta të fëmijëve, etj.

GDMF do të kontribuojë në zbatimin e rezolutave të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë që përmbajnë angazhime për të drejtat e fëmijëve ose që ndikojnë në jetën e tyre dhe të rezolutës “Për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara” (AZHQ2030) përsa i përket të drejtave të fëmijëve.